



USAID | **ALBANIA**
FROM THE AMERICAN PEOPLE

Për shpërndarje të menjëhershme:

09 korrik 2010

Për më shumë informacion:

Kontakti: Zj.Silvana Meko

Zyre: +355-4-2278-121

Cel: 0694033831

Email: smeko@lgpa.al

<http://albania.usaid.gov>

www.lgpa.al

PRESS RELEASE

Përmirësohen shërbimet publike për taksapaguesit në Kukës

KUKËS, 9 KORRIK 2010 Kryetari i Bashkisë së Kukësit, Z. Hasan Halilaj dhe Drejtori i Misionit të USAID në Shqipëri, z. Joseph C. Williams, përuruan sot sistemin e ri të kompjuterizuar të taksave vendore për bashkinë. Sistemi, i cili u zhvillua përmes Programit të USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA), mundëson një administrim më të efektshëm dhe më efikas të vjeljes së taksave dhe ofrimit të shërbimeve, që do të rezultojnë në të ardhura më të mëdha nga taksat për bashkinë dhe në shërbime më të mira për qytetarët.

Drejtorja e Tatimeve në Bashkinë e Kukësit i duhej ta bënte në mënyrë manuale pjesën më të madhe të punës së saj. Me sistemin e ri të kompjuterizuar, kjo drejtori do të jetë në gjendje të përlogarisë saktësisht detyrimet tatimore dhe të evidentojë pagesat e taksave, e madje të hartojë raporte parashikimesh të të ardhurave dhe analiza të të ardhurave, të cilat janë shumë të rëndësishme për zyrtarët e urbanistikës dhe zyra të tjera të bashkisë. Kompjuterizimi i sistemit të taksave do ta ndihmojë bashkinë të përmirësojë vjeljen e taksave dhe të rrisë të ardhurat e tyre në mënyrë që Kukësi të ofrojë shërbime bashkiake më të mira për qytetarët e saj. Gjithashtu, do të pakësojë ndërveprimet personale me inspektorët e tatimeve që shpesh konsiderohen si burim i praktikave korruptive.

Përmes bashkëpunimit me Qeverinë e Shqipërisë, USAID-i po zbaton disa ndryshime shtesë që do t'u mundësojnë bashkive përmirësimin e administrimit të tatim-taksave. Së bashku me Departamentin e Thesarit në Ministrinë e Financave, USAID-i ka modifikuar sistemin e kompjuterizuar të thesarit, në mënyrë që t'u mundësojë njësive vendore akses në të dhënat elektronike ditore që kanë lidhje me të gjitha të ardhurat tatimore dhe jo-tatimore të shpërndara sipas zërave në llogarinë e qeverisjes vendore. Gjithashtu, USAID-i po punon me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve që t'u mundësojë njësive të qeverisjes vendore akses në të dhënat elektronike të qarkullimit të tatimpaguesve, bazuar në kuponat e kasave regjistruese për ato biznese që ndodhen brenda kufijëve të tyre territorialë. Të dy sistemet mendohet të vihen në punë brenda muajve të ardhshëm.

Deri më sot, USAID-i e ka prezantuar sistemin e ri të kompjuterizuar të taksave vendore në 9 bashki, përfshirë Lezhën, Fierin, Fushë-Krujën, Korçën, Pogradecin, Shkodrën, Elbasanin, Gramshin dhe Kukësin. Në total, mbështetja e USAID-it për kompjuterizimin e drejtorive të taksave shkon në shumën mbi 37 milion lekë për 10 bashkitë, përfshirë bashkinë Kukës që arrin vlerën rreth 2 milionë Lekë.

Programi i USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA) punon me bashkitë partnere në Shqipëri për nxitjen e zhvillimit të ekonomisë vendore, për përmirësimin e qeverisjes vendore dhe për fuqizimin e pjesëmarrjes dhe angazhimit të shoqërisë civile dhe të sektorit privat në zhvillimin vendor. Bashkitë partnere të LGPA-s janë: Elbasani, Fieri, Fushë-Kruja, Gramshi, Korça, Kukësi, Lezha, Librazhdi, Pogradeci dhe Shkodra.

###